

Titulli i lëndës: **Mediet e reja**

Informatat themelore për lëndën		
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë – Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Mediet e reja	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, semestri i I-të 2024/25	
Numri i orëve në javë:	2 + 2	
Kreditë ECTS:	8	
Koha / Vendi:		
Mësimdhënësi:	Prof. Faton Ismajli, / Asistenti: MA Blerta Dibrani	
Të dhënat kontaktuese:	faton.ismajli@uni-pr.edu / blerta.dibrani@uni-pr.edu e-maili për detyra: detyrat.media@gmail.com	
Përshkrimi i lëndës:	Zhvillimi i hovshëm i mediave ka sjell në ndryshime edhe në performacën e tyre. Aspekti teknik ka ndryshuar edhe përceptimin e tyre, kështu që mediet e reja nuk janë asgjë më shumë, sesa përsosmëri teknologjike e mediave të vjetra. Ne botën moderne sot është e vështirë të paramendohet të mos të përdoret interneti apo edhe mjetet tjera teknike të sofistikuar që na çojnë drejt një bote virtuale informative të cilat e bëjnë me të lehtë komunikimin ku shpeshherë pothuajse zëvendësojnë edhe gjithë ambientin që na rrethon. Teknologjia digjitale ka shëndëruar shkrimin, fotografinë dhe zërin në një konvergencë të komunikimit në të mirë të përdorimit të shërbimit multimedial. Kjo lëndë ju ofron njohuri njohuri me forma të shumta rreth procesimit të informatave si të tekstit, zërit, grafikës, videove, animacioneve të cilat dita ditës gjejnë përdorim tek gati të gjitha mediat. Përmes kësaj lënde do të ofrohen njohuri teorike, praktike dhe teknike për mediet e reja konkretisht për portalet.	

Qëllimet e lëndës:	Së pari, sqarimi i aspektit teorik për mediet e reja dhe portalet, duke marrë shembuj teorik dhe praktikë për zhvillimin e gazetarisë online. Së dyti, kjo lëndë do të shërbejë për anën profesionale të mediave të reja dhe portaleve, duke diskutuar të gjitha strukturën, mënyrën e raportimit, kriteret e lajmit në portal deri te çrregullimi informativ. Së treti, kjo lënë do të sqarojë edhe anën ligjore të funksionimit të portaleve, duke e ndërlidhur edhe aspektin etik, meqë, mediet e reja, njëjërën prej sfidave më të mëdha kanë problemet etike. Së katërti, ligjërimi i kësaj lënde ka për qëllim që studentët t’i aftësojë për të mbledhë informacionin, për ta përpunuar dhe përshtatur kërkesës së portaleve. Poashtu, studentët aftësohen të krijojnë një portal, duke filluar nga qasja në internet e deri te format e financimit. Ata mësojnë se si bëhet lidhja e portalit me mediet sociale, për konvergjencën mediale në portal si dhe aftësohen për të publikuar tekst, video dhe foto në portal.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të semestrit studenti/ja do të jetë në gjendje të: 1. kuptojë aspektin teorik dhe praktikë të funksionimit të mediave të reja dhe portaleve; 2. Krijojë përmbajtje profesionale dhe kreative për mediat e reja dhe portalet; 3. krijojë një portal medial prej momentit kur blihet domeni; përgatitet platforma e deri te mënyra e financimit; 4. shkruajë tekste dhe t’i publikojë ato në portal; 5. Kupton çrregullimin inforamtiv 6. Kupton anën ligjore të funksionimit të mediave të reja dhe portaleve 7. Kryen hulumtime lidhur me zhvillimin e gazetarisë në interent si dhe kupton konceptet themelore të përdorimit te AI në gazetari.		
	Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)		
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min	15	5
Kollokfiume,seminare	20	1	30

Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	15	2	30
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			196 orë= 8 ECTS (206:25=8.24)
Metodat e mësimdhënies:	-ligjërata -ushtrime/ detyra të shtëpisë -projekti		
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja në ligjërata 10 Detyrat në klasë dhe në shtëpi 1-20 pikë; Detyra semestrale – punim kreativ 40 %(lajm për portal me tekst, foto, video, grafika dhe animacion) ose punim seminari me objekt studimi portalet (tema caktohet në konsultim me profesorin dhe asistenten) – Provimi 30%		
Literatura primare:	1. Eric Sherer, A na duhen gazetarët? 2. <i>Missouri Group, Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, Botimet IDK, 2010</i> [26-38; 372-387 dhe 408-422] 3. <i>Joseph R. Dominick, Dinamika e komunikimit masiv, Media në periudhën digjitale, UET Press, 2010</i> 4. <i>ABC-ja e gazetarisë, redaktuar nga Claudia Mast , FES 2021 (Prej 5-44; 125-146 dhe 397- 419)</i>		
Literatura shtesë:	1. David Randall, Gazetari universal, ISHM, 2003. 2. Russ-Mohl, Stephan (2010): Gazetaria. Tiranë: UET Press 3. Marek, Roman (2013): Understanding YouTube, Über Fascination eines Mediums.		

**Hartimi i planit
mësimor**

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në mediet interaktive – historia e mediave online
Java e dytë:	Shkrimi në mediet interaktive – raportimi i lajmeve në epokën digjitale
Java e tretë:	Aspektet ligjor dhe etike të rregullimit të mediave të reja
Java e katërt:	E drejta për t'u harruar në internet
Java e pestë:	Diskutimi për projektin - shkrimin e një teksti gazetar (detyra kryesore)
Java e gjashtë:	Raportimi i drejtpërdrejtë, sfidat profesionale dhe etike
Java e shtatë:	Konvergjenca mediale (TEKST, FOTO, VIDEO, GRAFIKA)
Java e tetë:	Ligjëratë nga një redaktor, gazetar
Java e nëntë:	Zhanret e çrregullimit informativ te portalet
Java e dhjetë:	Krijimi i një portali; prej blerjes së domenit, krijimit të CMS (Sistemi i menaxhimit të përmbajtjes) e deri te mënyra e financimit. (Mysafir - ekspert të themelimit të portaleve)
Java e njëmbëdhjetë:	Diskutimi final për projektin
Java e dymbëdhjetë:	Mediet e reja dhe ekonomia
Java e trembëdhjetë	Inteligjenca artificiale dhe mediet e reja
Java e katërmëdhjetë`	Përsëritje

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.